



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 700/2021

Dragica Gashiq

kundër

Komunës së Gjakovës

Drejtuar: Z. Ardian Gjini, kryetar
Komuna e Gjakovës

Prishtinë, më 25 gusht 2022

Qëllimi i raportit

Raporti është hartuar bazuar në ankesën individuale të znj. Dragica Gashiq dhe ka për qëllim t'i analizojë pohimet ankimore të ankueses dhe në përgjithësi rrethanat e rastit, në raport me obligimet e organeve të administratës komunale për ndërmarrjen e veprimeve sa i përket procesit të kthimit të ankueses, e cila ishte zhvendosur nga komuna e Gjakovës si pasojë e luftës në Kosovë në vitin 1999.

Baza kushtetuese dhe ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit ndër të tjera ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.”* (Neni 16, paragrafi 1).
 - *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
 - *“T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
 - *“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
 - *“T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
 - *“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
 - *“Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).
 - *“T'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t'i përmbushë këto përgjegjësi sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartcekura.

Rrethanat e rastit

3. Më 10 dhjetor 2021, znj. Gashiq, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor z. Predrag Miljković, i kishte parashtruar ankesë Avokatit të Popullit kundër Komunës së Gjakovës. Në ankesë ajo kishte theksuar se i kishte parashtruar kërkesë Drejtorisë për Urbanizëm e Komunës së Gjakovës që t'ia lejonte asaj rinovimin e banesës dhe ndërrimin derës së hyrjes, por nuk kishte marrë asnjëherë përgjigje. Në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, ajo kishte përshkruar procesin e kthimit dhe kishte theksuar: *“Kthimi i Dragica Gashiq si person i zhvendosur e cila në mënyrë ligjore e ktheu të drejtën e shfrytëzimit të banesës, Komuna e Gjakovës. (...) mbi çdo bazë. (...) pamundëson, parandalon ose dëbon nga banesa pa dhënë asnjë justifikim të vlefshëm.”*
4. Sipas të dhënave që kemi në dispozicion, më 6 maj 1997, nga qeverisja e atëhershme komunale, me Aktvendimin nr. 01-360-391 për ndarje të banesës, ankuesja pati fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës në Gjakovë, në rrugën “Orize”, nr. 8, kati 2, banesa nr. 1677, me sipërfaqe prej 53.58m², për kohë të pacaktuar. Kontrata ishte lidhur ndërmjet ankueses dhe Ndërmarrjes Publike për Shërbime Banesore dhe Ndërtimore Komunale të Gjakovës.
5. Ankuesja ishte larguar nga banesa në vitin 1999 për arsye sigurie, siç kishte pohuar ajo, për shkak të luftës në Kosovë. Gjatë viteve në vijim, sipas ankueses, palët e treta kishin uzurpuar në mënyrë të përsëritur pronën e paluajtshme.
6. Më 27 qershor 2003, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, me Kërkesën nr. DS005311, parashtruar nga znj. Gashiq kundër të paditurit A. R., kishte nxjerrë Vendimin nr. HPCC/D/79/2003/C, me të cilin kishte urdhëruar:
 1. *Që parashtruesit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore siç mund të jetë rasti, t'i kthehet në posedim prona e cila është lëndë e kërkesës;*
 2. *Që i padituri ose cilido person tjetër që gjendet në pronë ose, ku banori nuk ka marrë pjesë në lëndë, të gjithë personat që aktualisht gjenden në pronë, ta lirojnë të njëjtën brenda afatit 30 ditor nga dorëzimi i këtij vendimi; dhe*
 3. *Nëse i padituri ose cilido person tjetër që gjendet në pronë nuk e zbaton urdhrin për lirim brenda afatit të caktuar do të dëbohen nga prona.*
7. Më 17 tetor 2003, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, me Kërkesën nr. DS602543, parashtruar nga znj. Gashiq kundër të paditurit F. E., kishte nxjerrë Vendimin HPCC/D/93/2003/C, me të cilin kishte urdhëruar:
 1. *Parashtruesit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit t'i jepet në posedim prona e kërkuar;*
 2. *I padituri dhe çdo person tjetër që gjendet në pronë, ose ku banori aktual nuk ka marrë pjesë në lëndë, të gjithë personat që aktualisht gjenden në pronë ta lirojnë të njëjtën në afat prej 30 ditësh nga dorëzimi i këtij vendimi; dhe*
 3. *Nëse i padituri ose cilido person tjetër që gjendet në pronë nuk e zbaton urdhrin për lirim brenda kohës së caktuar ata do të dëbohen nga prona.*

8. Më 2 prill 2004, ankuesja i kishte parashtruar Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore kërkesë për administrim të pronës pas Vendimit nr. HPCC/D/79/2003/C të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore.
9. Më 22 tetor 2004, përveç të tjerash, edhe mbi bazën e kërkesës së A. R., Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, me Vendimin HPCC/REC/40/2004, në 202 kërkesa të identifikuar (në mesin e të cilave edhe kërkesa e A. R.) Komisioni kishte urdhëruar se kërkesa për rivlerësim duhej të refuzohej.
10. Më 16 shkurt 2007 ishte nënshkruar Pajtueshmëria e bartësit të së drejtës, përkatësisht ankueses, që banesa në fjalë të përfshihej në programin e skemës së qiradhënies nga Agjencia Kosovare e Pronës.
11. Më 26 maj 2008, znj. Gashiq i ishte drejtuar me ankesë Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore në lidhje me kërkesën e aprovuar për pagim të qirasë dhe kishte pohuar se deri asokohe asaj i ishte paguar vetëm një pagesë e qirasë, më 8 nëntor 2007, dhe që nga ajo datë nuk kishte marrë asnjë pagesë tjetër si kompensim për qiranë sipas lëndës DS005311.
12. Më 24 korrik 2020, në Agjencinë për Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ankuesja kishte parashtruar kërkesë për riposedimin e pronës KPA#DS05311.
13. Më 9 qershor 2021, nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ishte lëshuar *Protokolli mbi Dorëzimin e Çelësave – Fletëdorëzim*, i cili vërtetonte se znj. Gashiq i kishte marrë nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore çelësat e pronës - objekt i kërkesës me nr. DS005311.
14. Më 10 qershor 2021, përfaqësuesit e UNHCR-së kishin hartuar një formular vlerësimi për të kthyerit vullnetarë nga komunitetet pakicë, ku thuhej: *“Zonja është kthyer në banesën e cila ishte uzurpuar, por është liruar nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe Policia e Kosovës. Apartamenti është plotësisht i zbrazët, kemi nevojë urgjente për mobilje dhe ushqim. Ajo vuan nga diabeti, merr insulinë, ndaj duhet një frigorifer që të mos prishet insulina. Apartamenti ka nevojë për rinovim pasi është në gjendje shumë të keqe.”*
15. Më 10 qershor 2021, përfaqësuesit e ZKK-së së Gjakovës, pasi kishin marrë informatën nga OSBE-ja dhe UNHCR-ja për kthimin e ankueses, kishin vizituar apartamentin e ankueses. Gjatë vizitës së përfaqësuesve të ZKK-së, IOM-it dhe UNHCR-së ishin identifikuar nevojat bazë, sipas Formularit të vlerësimit të UNHCR-së për të kthyerit vullnetarë dhe me këtë rast kishin konstatuar se apartamenti është pa mobilje, ishin të dëmtuara dyshemeja, dyert dhe dritaret.
16. Më 11 qershor 2021, shefi i zyrës së ZKK-së së Komunës së Gjakovës, nëpërmjet postës elektronike ia kishte drejtuar Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) një kërkesë me të cilën theksonte nevojën për dorëzim urgjent të ushqimeve dhe mjeteve higjienike dhe të shikohej mundësia e rinovimit sa më shpejt të banesës, sepse ishte shumë e dëmtuar dhe i mungonin kushtet elementare të jetesës.
17. Më 16 qershor 2021, shefi i zyrës së ZKK-së së Gjakovës, përmes postës elektronike i kishte drejtuar ftesë Komisionit Komunal për Kthim për mbajtjen e një seance më 18 qershor 2022, me rendin e ditës: *“Shqyrtimi i renovimit të banesës së personit të kthyer Dragica Gashiq.”*

18. Më 21 qershor 2021 ishte mbajtur mbledhja e Komisionit Komunal për Kthim. Në mbledhje kishin marrë pjesë përfaqësuesit e qeverisjes lokale, ata të MKK-së, IOM-it, UNHCR-së, OSBE-së. Në procesverbalin e takimit ishte konstatuar se ankuesja ishte kthyer në Gjakovë me iniciativë të saj dhe jo në mënyrë të organizuar përmes ZKK-së.
19. Sipas procesverbalit nga takimi i datës 21 qershor 2021 të Komisionit Komunal për Kthim i Komunës së Gjakovës kuptohet se më 9 qershor 2021 shefi i Zyrës për Komunitete i Komunës së Klinës dhe OSBE-ja kishin njoftuar shefin e Zyrës për Komunitete i Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme: ZKK Gjakovë) për kthimin në banesë të znj. Gashiq. Në procesverbalin e sipërpërmendur theksohej se përfaqësuesit e International Organization for Migration (IOM), Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjat (United Nations High Commissioner for Refugees - UNHCR), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) kishin shprehur gatishmërinë e tyre për regjistrimin e ankueses si person i kthyer. Sipas procesverbalit nga ky takim, Komisioni Komunal për Kthim kishte nxjerrë përfundimin se rinovimi i banesës nuk mund të miratohej për shkak se nuk ishin plotësuar kërkesat ligjore për pronësinë. Në fakt ishte konstatuar se banesa ishte në pronësi të Komunës së Gjakovës, kurse ankuesja ishte vetëm qiramarrëse e patundshmërisë.¹
20. Sipas pohimeve të ankueses, pas kthimit në banesë, ajo kishte pranuar derën e hyrjes donacion nga e ashtuquajtura Zyra për Kosovën e Serbisë dhe po kjo zyrë kishte angazhuar një kompani nga Klina që ta vendoste atë. Në të njëjtën ditë, gjithnjë sipas pohimeve të ankueses, zyrtarë të inspektoratit të Komunës së Gjakovës kishin ndaluar ndërrimin e derës së hyrjes dhe e kishin njoftuar gojarisht atë se për çdo ndryshim në banesë ajo duhej të kërkonte leje nga organet komunale. Me atë rast ata i kishin shqiptuar gjobë në vlerën prej 400 eurosh personit që ishte angazhuar për vendosjen e derës së hyrjes.
21. Më 30 qershor 2021, znj. Gashiq i ishte drejtuar me shkrim Komunës së Gjakovës me kërkesë për lejimin e ndërrimit të derës së hyrjes, por sipas saj, për kërkesën në fjalë nuk kishte marrë përgjigje deri në ditën kur ajo i ishte drejtuar Avokatit të Popullit.
22. Më 16 korrik 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kishte zhvilluar një takim me zyrtarët përgjegjës të ZKK-së së Gjakovës, me qëllim që të merrte informacione lidhur me shqetësimet e ngritura, për të cilat ishte raportuar në media lidhur me situatën e krijuar pas kthimit të ankueses në Gjakovë, dhe veçanërisht lidhur me veprimet të cilat i kishte ndërmarrë Komuna e Gjakovës.
23. Në takim ata kishin theksuar se pasi lajmi për kthimin e znj. Gashiq në Gjakovë kishte dalë në media, situata ishte komplikuar edhe më tej, duke theksuar po ashtu se ajo kishte qëndruar për dhjetë ditë në banesë dhe nuk ishte shqetësuar nga askush. Sipas pohimeve të përfaqësuesit përgjegjës të ZKK-së së Gjakovës, ata ishin në gjendje t'i siguronin ankueses strehim në atë mënyrë që t'ia paguanin qiranë e banesës ku ajo mund ta gjente në një vend tjetër, gjë që ishin të obliguar ta bënin sipas Rregullores Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.

¹ Procesverbali nga takimi i parë i Komisionit Komunal për Kthim i Komunës së Gjakovës, i datës 21 qershor 2021.

24. Në po këtë takim ishte theksuar se Komuna e Gjakovës kishte përgatitur padi për shkëputjen e kontratës për qiramarrjen e banesës në fjalë dhe do të kërkonte aplikimin e masës së sigurisë.
25. Më 23 gusht 2021, Komuna e Gjakovës i kishte parashtruar Gjykatës Themelore në Gjakovë *“Padi për anulimin e kontratës për dhënien me qera të banesës me propozim për caktimin e masës së sigurisë”*. Në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, Komuna kishte kërkuar nga gjykata: *“I NDALOHET Kundërshtares së sigurimit, Dragica Gashiq që personalisht të qëndrojë-shfrytëzojë apo banojë në banesën sipas certifikatës 144/21 dt. 28.06.2021 pra në njesinë kadastrale -70705028-05102-2-45-4-12-0 për të cilën sipas certifikatës është vërtetuar se Komuna e Gjakovës është pronare e vetme.”*
26. Gjykata Themelore në Gjakovë kishte shqyrtuar padinë në procedurë urgjente dhe më 9 gusht 2021 kishte refuzuar pjesën që i referohej masës së sigurisë, kurse procedura lidhur me çështjen kryesore të kontestit kishte mbetur të shqyrtohej në procedurë të rregullt.
27. Më 9 mars 2022, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë mbajtur një takim me përfaqësuesit e Komunës së Gjakovës, me qëllim që të informoheshin për procedurat që Komuna e Gjakovës i ka ndërmarrë apo që planifikon t'i ndërmarrë lidhur me rastin e ankueses.
28. Më 5 prill 2022, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit është takuar me përfaqësuesin Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) për ta analizuar dokumentacionin e paraqitur dhe informatat shtesë lidhur me zbatimin e dëbimit të AKKVP-së në rastin e ankueses.
29. Më 6 prill 2022, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është takuar me përfaqësuesit e Komunës së Gjakovës nga të cilët është informuar se ankuesja, në kërkesën e parashtruar më 30 qershor 2021 për ndërrimin e derës së hyrjes, kishte marrë përgjigje nga Komuna më 13 gusht 2021. Personat përgjegjës me këtë rast kanë sqaruar se, meqenëse ankuesja pretendon se nuk ka marrë përgjigje, e njëjta përgjigje do t'i dërgohet menjëherë, dhe me bashkëngjitje të kopjes së shkresës së datës 13 gusht 2021, si dhe njoftimi i fundit drejtuar ankueses, i datës 6 prill 2022, i janë dorëzuar përfaqësuesit të Avokatit të Popullit.
30. Në njoftimin e Komunës së Gjakovës, i datës 6 prill 2022, thuhej: *“Me qëllim që të procedohet kërkesa për leje për ndërrimin e derës hyrëse, duhet të paraqisni dhe dokumentoni të drejtën e përdorimit të kësaj njesie banimi me dokumentacionin përkatës kadastral brenda 7 ditëve, në të kundërt procedura do të pezullohet.”*
31. Më 17 maj 2022, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka biseduar me ankuesen, e cila ka theksuar se për shkak të përkeqësimit të gjendjes së saj shëndetësore është shtruar në spital dhe pasi është kthyer në banesë ka gjetur një letër poshtë derës. Siç thekson ajo, nuk e ka kuptuar përmbajtjen e letrës për shkak se ishte në gjuhën shqipe dhe letrën në fjalë ia ka dërguar menjëherë përfaqësuesit të saj ligjor.
32. Më 17 maj 2022, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka biseduar me ankuesen, e cila ka theksuar se është vizituar nga një zyrtar i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili ia ka ofruar një dokument dhe e ka njoftuar atë në lidhje me mundësinë e blerjes së banesës brenda afatit 2 vjeçar. Në fakt ai dokument ishte kopja e ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

33. Më 6 qershor 2022, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka biseduar me përfaqësuesin ligjor të ankueses, avokatin z. Predrag Miljković, i cili ka shprehur pakënaqësinë se përgjigjja e Komunës së Gjakovës nuk është në pajtim me Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas tij, Komuna do të duhej të komunikonte me ankuesen në gjuhën e saj, ngase ajo nuk kupton gjuhë tjetër përveç gjuhës serbe.
34. Gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i ankueses ka theksuar se me përgjigjen e Komunës së Gjakovës, e datës 13 gusht 2021, ishte kërkuar dëshmia për të drejtën e shfrytëzimit të banesës, gjë e cila ishte e paarsyeshme, për faktin se me rastin e paraqitjes së padisë në gjykatë, Komuna si provë e kishte cituar Kontratën për shfrytëzimin e banesës, gjë që rezultoi se Komuna kishte njohuri për të drejtën e banimit të ankueses.
35. Me parashtrësën dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në lëndën e iniciuar nga pala përgjegjëse, ankuesja kishte theksuar se vazhdimisht që nga viti 1999 e deri më sot ka realizuar pagesa në emër të tatimit mbi pronën e paluajtshme në kuptimin e detyrimeve komunale, kurse pohimet e veta i mbështet me prova në formë të faturave, të cilat ia ka dorëzuar gjykatës për vlerësim.

Analiza e çështjes

36. Avokati i Popullit thekson se parimi i barazisë është parimi themelor i rendit juridik shtetëror, bazë mbi të cilën bazohet dhe ndërtohet rendi juridik, por edhe e drejtë themelore e qytetarëve e garantuar me Kushtetutë.²
37. Lidhur me këtë, vendimet e organeve të administratës ndikojnë në realizimin e të drejtave të qytetarëve të parashikuara me ligj. Ato vendosin norma të përgjithshme në një fushë të gjerë të veprimtarisë administrative, prandaj qoftë nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, qoftë nga pikëpamja e shtetit të së drejtës, është e rëndësishme që vendimet e organeve administrative të jenë të ligjshme dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Zbatimi unik i ligjit, pra dhe i së drejtës administrative, është padyshim një detyrim i çdo sistemi juridik.
38. Është i pakontestueshëm fakti se ankuesja është vendosur në një banesë në pronësi komunale në bazë të një kontrate për shfrytëzimin e banesës dhe një kontrate qiraje duke e fituar të drejtën për ta përdorur atë për t'i përmbushur nevojat e saj familjare për strehim, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen mbi qiranë e banesës, e datës 6 maj 1997. E njëjta marrëveshje përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e palëve në përdorimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e banesës. E drejta e shfrytëzimit të banesës është e drejtë e konfirmuar edhe me vendimet e më vonshme të Agjencisë Kosovare të Pronave (shih paragrafët 6-13).
39. Në bazë të shqyrtimit dokumentacionit përkatës, Avokati i Popullit nuk ka në dispozicion ndonjë informacion nëse në rastet e pronave të tjera në pronësi komunale, që për nga natyra janë me status të njëjtë apo të ngjashëm me pronën që tanimë është objekt kontesti, Komuna e Gjakovës nuk ka ndërmarrë çfarëdo mase administrative apo gjyqësore ndaj personave të tjerë të cilët banojnë në ato objekte banimi. Po ashtu nuk ka të dhëna nëse Komuna e Gjakovës ka ndërmarrë ndonjëherë masa as ndaj palëve të treta që kanë qëndruar në të njëjtën banesë.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 24, definon: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim."

1.2. Riparimet;

1.3. Ndërtimi ose rindërtimi;

1.4. Mbështetja përmes alokimit të tokës me të drejtat e shfrytëzimit për rastet e veçanta, sipas ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Mbështetja përmes programeve të banimit social sipas ligjit në fuqi, deri në zgjidhjen e qëndrueshme të banimit.”

Ndërsa në paragrafin 2 thekson:

“2. Qiraja ofrohet si masë e përkohshme e akomodimit për të kthyerin deri në zgjidhjen e qëndrueshme të banimit në rastet kur:

2.1. Nuk ka burime financiare në dispozicion të përballojë strehimin;

2.2. Nuk ka familjar që mund t'i akomodojnë të kthyerit;

2.3. Nuk ka pronë banimi në dispozicion;

2.4. Prona është në dispozicion, por nuk është menjëherë e qasshme për shkak të rripesimit të pronës, riparimit ose (ri) ndërtimit;

2.5. Qiraja për të kthyerit e kategorizuar në kategorinë e rëndë jepet për periudhën nga 3 deri në 12 muaj, varësisht nga kapacitetet financiare;

2.6. Pas kalimit të afatit për akomodim, komuna përkatëse në pajtim me ligjin në fuqi siguron strehim përmes programeve të strehimit social sipas ligjit në fuqi.”

Konstatimet e Avokatit të Popullit

46. Nga informacionet që ka në dispozicion Avokati i Popullit, mund të konstatohet se znj. Gashiq kishte vendosur individualisht dhe në mënyrë spontane që të kthehej në banesë me të drejtë posedimi tanimë të konfirmuar. Edhe pse autoritetet përkatëse komunale nuk ishin njoftuar paraprakisht dhe procesi i kthimit nuk ishte i koordinuar përmes tyre, nuk do të thotë se po ato autoritete shkëputen nga përgjegjësia që kanë për të mirë administruar proceset që zhvillohen në territorin ku shtrihet kompetenca e tyre. Kthimi i personave të zhvendosur ka dimensionin kompleks në vetvete dhe autoritetet duhet të jenë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme për mënyrën se si i përmbushin detyrimet dhe rolin që kanë.
47. Standardi i miradministrimit nënkupton një qëndrim aktiv dhe të angazhuar të organit të administratës ndaj kryerjes së detyrave brenda fushëveprimit të tij dhe kryerjes së ligjshme të atyre detyrave për ta arritur qëllimin, për të cilin këtij organi i janë dhënë kompetenca publike.
48. Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme do të duhej të shërbente si bazë mbi të cilën autoritetet komunale do të ushtronin veprimtarinë e tyre në drejtim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm për kthimin e ankueses, e që në këtë rast duket se ka munguar zbatimi i plotë i saj.
49. Avokati i Popullit konstaton se periudha e gjatë kohore e procedurave administrative në Komunën e Gjakovës, si dhe komunikimi joefikas, ka krijuar një situatë të paqartë për ankuesen, në lidhje me mundësinë e saj për të gëzuar në mënyrë paqësore të drejtat e

garantuara. Organet komunale nuk arritën t'ia siguronin ankueses të drejtën e saj për shfrytëzimin e një të drejte të konfirmuar me vendime administrative.

50. Avokati i Popullit konstaton se komunikimi zyrtar i organeve të administratës me ankuesen është në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare.

51. E drejta e shfrytëzimit të banesës ishte konfirmuar me vendimet e organit kompetent që trajton çështjet pronësore të kësaj natyre në Kosovë. Asnjë procedurë gjyqësore dhe asnjë veprim tjetër administrativ për kontestimin e kësaj nuk u ndërmor nga organet komunale në lidhje me këtë pronë deri në momentin e kthimit të ankueses.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“(…) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (…);* si dhe: *“Të rekomandojë (…)* nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, paragrafi 1.7). Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Gjakovës:

- *Të respektohet Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, të lejohet parashtruesja e ankesës ta përshtatë ambientin e brendshëm të pronës në fjalë, si dhe t'i mundësohet asaj ta shfrytëzojë lirshëm atë dhe pa pengesa të tjera.*
- *Organet e administratës komunale ta zbatojnë ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe komunikimi zyrtar me parashtruesen e ankesës të zhvillohet sipas kërkesave të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (…)* duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Naïm Qelaj

Avokat i Popullit

Kopje:

Zyra e Komisionarit për Gjuhët